

Komisioni i Auditimit të KRU. "Hidromorava" - SH.A., Gjilan, në cilësinë e panelit intervistues dhe vlerësues, mbi bazën e vlerësimeve individuale të panelistëve, vlerësimit dhe poentimit mesatar të dalë nga vlerësimet individuale, në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 21 dhe 25, pika h, të Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, lidhur me dispozitat ligjore të nenit 13 të Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, pas zhvillimit të procedurave të konkursit publik (rishpallje të konkursit), me nr. 1838 të datës 31.12.2024, merr këtë:

## V E N D I M

Për pozitën **Zyrtar i Auditimit të Brendshëm** në KRU. "Hidromorava" - SH.A., sipas konkursit publik (rishpallje e konkursit), me nr. ref.1838, i publikuar me datë 31.12.2024, **Avdyll Kastrati**, prej 30 pikëve maksimale, është vlerësuar me 21,3 pikë si kandidati më i suksesshëm për këtë pozitë, bazuar në mesataren e pikëve nga panelistët.

## A r s y c t i m

Komisioni i Auditimit të KRU. "Hidromorava" - SH.A., Gjilan, pas zhvillimit të procedurave të rekrutimit sipas Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, lidhur me Ligjin nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, dhe kërkesave të përgjithshme të konkursit publik (të rishpallur), me nr. ref.1838, i publikuar me datë 31.12.2024, ka zhvilluar të gjitha procedurat e nevojshme ligjore dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilla Juridike:** Kandidatët e pakënaqur me këtë vendim mund të ushtrojnë ankesë në afatin prej 8 (tetë) ditëve kalendarike nga dita e pranimit të këtij vendimi pranë Komisionit të Auditimit në KRU "Hidromorava" SH.A.

Ankesat të dërgohen në e-mail adresën: [rekrutimi.hidromorava@yahoo.com](mailto:rekrutimi.hidromorava@yahoo.com).

Komisioni i Auditimit  
  
(znj. Ferdane Tahiri Sylejmani)  
Kryesuese e Komisionit të Auditimit

